- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.	Mirëmbajtje e Sistemit të Vlerësimit të Performancës	24 muaj			
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

MIRËMBAJTJE E SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit: Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemit të Vlerësimit të Performancës janë të shprehura në komponentët e mëposhtme:

1. Monitorimi periodik i rregullt i roleve dhe aktivitetit të përdoruesve të sistemit. Kompania në bashkëpunim me BT duhet të nxjerrë raporte pas monitorimeve periodike të cilat duhet të përfshijnë:
 - a) Mos funksionim të shërbimeve të instaluar në rolet përkatëse.
 - b) Rritjen e madhësisë së logeve në masën që ndikojnë në performancën e sistemit.
 - c) Performancën dhe disponueshmërinë e ulët të sistemit.
2. Vlerësim i raporteve të monitorimit dhe përpilim i raporteve për përmirësimin e infrastrukturës, pa përjashtuar edhe sugjerimet në adresë të infrastrukturës.
3. Marrja, dokumentimi dhe dhënia e zgjidhjeve me prioritet të çështjeve të raportuara nga stafi duke ndihmuar stafin e BT në përdorimin e sistemit.
 - Dhënia suport në kryerjen e procedurave në kuadër të procesit të vlerësimit.
 - Marrja dhe dokumentimi i raportimit të bug-eve.
 - Mbledhja dhe dokumentimi i kërkesave për ndryshim.
4. Kthimi i sistemit në gjendjen e mëparshme para se të ndodhte problemi. Kjo mund të përfshijë një rregullim të përhershëm ose një zgjidhje të përkohshme deri sa zgjidhja përfundimtare të gjendet.
 - Kryerja e rregullimeve të bug-eve të sistemit.
 - Rifitimi i funksionaliteteve pas mbylljes së sistemit në mënyrë jo normale.
 - Kryerja e analizës së plotë të shkakut nga vjen.
5. Rregullimi i çështjeve/incidenteve në të gjithë shtresat e sistemit.
6. Asistencë për raporte ose “queries” sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
7. Planifikimi, menaxhimi i performancës së aplikimeve. Rregullimi i çdo çështje performance nëpërmjet update-mit dhe/ose ribërjes së aplikacionit.
8. Kompania duhet të garantojë suport në rast se një faktor i brendshëm apo i jashtëm afekton sistemin.
9. Ndërhyrjet në sistem duhet të propozohen me një akt plan të detajuar për t’u aprovuar. Kompania duhet të bëjë ndërhyrjet në kohën e përcaktuar.
10. Modifikimi dhe përmirësimi i funksionaliteteve sipas kërkesave të Autoritetit. Pavarësisht se kjo kontratë synon procesin e mirëmbajtjes së Sistemit të Vlerësimit të Performancës, mund t’i lindë nevoja që herë pas here të kërkojë azhornimin, përmirësimin apo modifikimin e sistemit duke u fokusuar por pa u kufizuar në:
 - Modifikimin e formularëve të përdorur në rast se do të jetë e nevojshme, sipas kërkesave ligjore.
 - Përmirësimi i performancës së proceseve aktuale
 - Përmirësimi i raporteve aktuale që gjenerohen nga sistemi sipas kërkesave të institucionit.
11. Kompania duhet të kryejë kontroll periodik mujor, monitorues në vendndodhjen e klientit.
12. Transferimi i njohurive stafit IT dhe stafit përdorues të sistemit.
 - Trajnimi mbi funksionalitetet e sistemit

-
- Trajnimi mbi konfigurimin dhe monitorimin e sistemit
 - Trajnimi mbi strukturën e databazës dhe source code e sistemit.
 - Nëse do të nevojitet parametrizim i ri, kompania duhet t'i japë asistencë stafit IT .
13. Ndërhyrjet në sistem duhet të propozohen me një akt plan të detajuar për t'u aprovuar. Kompania duhet të bëjë ndërhyrjet në kohën e përcaktuar.
 14. Kompania duhet të ofrojë suport lokal nga e hëna në të premte **08:00-17:00** deri në përfundimin e kontratës së mirëmbajtjes.
 15. Suporti i ofruar duhet të përfshijë kontrollet e detyrueshme parandaluese si dhe të përshkruajë dinamikat dhe furnizojë të gjitha detajet teknike mbi aktivitetet e planifikuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Referuar Termave të referencës në DST

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Mirëmbajtje e Sistemit të Vlerësimit të Performancës

Afatet e ekzekutimit: Afati i shërbimit do të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare/24 (njëzet e katër) muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Mirëmbajtje e Sistemit të Vlerësimit të Performancës	24	Bashkia Tiranë	24 (njëzet e katër) muaj

Shtojca 7

TERMAT E REFERENCES

QËLLIMI I SHËRBIMIT

Qëllimi i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e Sistemit të Vlerësimit të Performancës, i cili është i hostuar në infrastrukturën përkatëse në dhomën e serverave të Bashkisë Tiranë. Tashmë nëpërmjet këtij sistemi realizohet në mënyrë elektronike procesi i vlerësimit të performancës për administratën e Institucionit (nëpunësit civil si dhe nëpunësit në periudhë prove të shërbimit civil).

Disponueshmëria dhe vazhdimësia e funksionueshërisë së pandërprerë të këtij sistemi, është shumë e rëndësishme për të realizuar në vijueshmëri të pandërprerë procesin e vlerësimit.

OBJEKTI I SHËRBIMIT

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e Sistemit të Vlerësimit të Performancës në çdo komponent të tij, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës mbi 99.9% në të gjithë komponentët dhe shërbimet e ofruara nga ky sistem dhe të korrigjojë çdo defekt që mund të shfaqet pa kosto shtesë, gjatë gjithë periudhës së mirëmbajtjes së sistemit.

Komponentët kryesorë të sistemit janë:

Software Aplikativ i cili përfshin:

Databazën e Sistemit me të gjithë komponentët përbërës.

AFATI I SHËRBIMIT

Afati i shërbimit do të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga data e nënshkrimit të kontratës.

ÇFARË ËSHTË SISTEMI

4.1 Përshkrim i Përgjithshëm


Sistemi i Vlerësimit të Performancës është i aksesueshëm nga të gjithë punonjësit (nëpunësit civilë dhe nëpunësit civilë në periudhë prove) e Administratës së Bashkisë Tiranë, duke ju mundësuar atyre të kryejnë të gjithë hapat e nevojshëm bazuar në pozicionin e tyre të punës në kuadër të procesit të vlerësimit të performancës. Ky sistem është i aksesueshëm në web nga punonjësit nëpërmjet llogarive të tyre (sistemi është integruar me sistemin LDAP të Institucionit) të parakonfiguruar me të drejtat përkatëse nëpërmjet linkut : <https://performanca.tirana.al> . Sistemi gjithashtu është i integruar përmes WEB API me Sistemin e Menaxhimit Financiar nga i cili thërret në kohë reale strukturën organizative të Bashkisë Tiranë së bashku me të dhënat për punonjësit.

Ky sistem është ndërtuar mbi bazën e një software të quajtur IMPRO, i cili në vetvete është krijuar me gjuhën e programimit Python (gjuhë e nivelit të lartë).

4.2 Dizenjimi i Sistemit

4.2.1 Arkitektura e sistemit

Sistemi është i bazuar në një arkitekturë me tre shtresa dhe është në gjendje të suportoje shumë përdorues. Shtresa e aplikacionit përmban bazën kryesore funksionale.



4.2.2 Data STORE (Baza e të dhënave)

Sistemi përdor një bazë të dhënash relacionale, duke shfrytëzuar të gjithë përparësitë e bazave të të dhënave relacionale: id unike, integriteti relational, përgjigje eficiente ndaj kërkesave. Shtresa e quajtur “Data Store” e cila është shtresa që merret me ruajtjen e të dhënave përbëhet nga Databaza PostgreSQL. PostgreSQL përmban të gjithë të dhënat e Application Layer dhe pothuajse të gjithë konfigurimet.

4.2.3 ORM Layer

Pjesa më e madhe e aksesit në këtë bazë të dhënash realizohet me anë të ORM (Object-relational mapping).

Serveri – ORM: Shtresa ORM përmban funksionalitete shtesë dhe thelbësore në majë të PostgreSQL-së. Modelet që përshkruhen në python krijojnë strukturat e nevojshme nëpërmjet ORM-së në PostgreSQL. Të gjitha veçoritë që ka baza e të dhënave si unique constraints ose lidhjet midis tabelave, përfitohen nga Pythoni. Indeksimet në këtë skemë kryhen mbi bazën e celësive ‘surrogate’ dhe jo atyre real/natyrat.

4.2.4 Application Layer

Kjo shtresë implementon logjikën e biznesit të aplikacionit dhe e organizon atë në komponentë. Është përgjegjëse për ndërlidhjen e komponentëve për të realizuar logjikën e biznesit duke e organizuar atë në formën e rrjedhave statike të punës (workflows). Shtresa është përgjegjëse për aktivitete lidhur me trajtimin e gabimeve, edhe pse çdo shtresë ka mekanizmat e saj të trajtimit të gabimeve. Kjo shtresë përmban logjikën ‘client’ në komunikimin dhe integrimin me Shërbime Web të cilat konsumohen nga sistemi. Librari të gatshme që aktualisht përdoren për të mbuluar kërkesat funksionale dhe jo funksionale të sistemit, janë pjesë e kësaj shtrese.

4.2.5 Presentation Layer

Kjo shtresë është përgjegjëse për prezantimin e të dhënave dhe për ndërveprimin me përdoruesin. Është implementuar duke respektuar çdo princip për UI si ripërdorueshmëria e dizajnit, thjeshtësia, dukshmëria, tolerancë dhe ndërveprim me reagim nga sistemi. Shtresat që përdoren në këtë layer janë si më poshtë:

User Interface Components: Të gjithë komponentët e ndërfaqes ndërtohen në XML + HTML, ndërkohë në menunë e Konfigurimeve mund të ndryshohen nga një përdorues me të drejta të caktuara vizibiliteti, pozicioni i shfaqjes etj.

4.2.6 Api

Aplikacione të tjera që (mund të) shfrytëzojnë/konsumojnë aplikacionin-n, të cilat mund të jenë desktop application ose web application, e realizojnë këtë nëpërmjet webshërbimit i cili suporton protokollet XML-RPC ose NET-RPC. XML-RPC mund të përdoret me Python, Java, Perl, PHP, C, C++, Ruby,.NET dhe shumë gjuhë të tjera programimi.

4.2.7 Communication

Shtresa e komunikimit është përfshirë konceptualisht si një shtresë vertikale, që nënkupton se çdo shtresë horizontale e sipërpërmendur komunikon duke respektuar protokollet e shtresës poshtë saj. Çdo shtresë gjithashtu publikon protokollet dhe modelet e komunikimit për shtresën sipër saj.

4.2.8 Auditing & Security Logs

- Aplikacioni ofron funksionalitete për monitorimin dhe auditimin e të gjithë veprimeve në sistem.
- Sistemi ofron të gjithë parametrat e sigurisë lidhur me autentikimin dhe kredencialet e llogarive.


ANALIZA E PROCESEVE TË PUNËS

Në vijim përshkruhen gjerësisht proceset e punës dhe funksionet e detajuara për secilin prej tyre. Proceset e punës ndjekin një rradhë të mirëpërcaktuar si në skemat e mëposhtme.


Procesi I




Procesi II




Procesi III




Procesi IV




Procesi V




Procesi VI



PROCESI VII



PROCESI VIII



5.1 Modulet kryesore të sistemit

Sistemi është tërësisht modular, ku lista e moduleve aktive është e menaxhueshme nga ndërfaqja.

Të gjithë modulet janë të integruar me njëri-tjetrin dhe qëndrojnë mbi një platformë të përbashkët.

Moduli i Vlerësimeve

Ky është moduli kryesor i cili aksesohet nga të gjithë rolet e përdoruesve në sistem dhe përfshin të gjitha proceset e Vlerësimit të Rezultateve në Punë. Seksione apo funksionalitete të këtij moduli gjenden si më poshtë:

- **Seksioni “Objektivat e bashkisë” ku mund të shtohen objektivat në bazë të hierarkisë së organigramës së Bashkisë Tiranë.**
- **Seksioni i krijimit të vlerësimit individual për secilin nëpunës civil.**
- **Krijimi i formularëve të vlerësimit nga përdoruesit në rolin Zyrtar Raportues.**
- **Seksioni i Gjenerimit të Raporteve statistikore në cdo kohë nga Drejtoria e Vlerësimit të Performancës.**

Sistemi mundëson gjenerimin e raporteve në formate të ndryshme në lidhje me cdo informacion të cilin ai përmban. Disa nga raportet kryesore që gjenerohen janë:

- Raport mbi vlerësimin e punonjësve
- Raport mbi vlerësimin progresiv të punonjësve
- Raport mbi numrin e punonjësve sipas gjinisë
- Raport mbi numrin e punonjësve sipas gjinisë progresiv
- Raport për koeficientët e vlerësimit
- Raport për koeficientet e vlerësimit progresiv
- Raport mbi klasifikimin e punonjësve
- Raport mbi identifikimin e nevojave për trajnim
- Monitorimi i procesit të punës
- Raporti i Vlerësimit të Punonjësit
- **Seksioni i Printimit të Formularit të Vlerësimit nga vet nëpunësi civil.**

Ky modul ruan të gjithë historikun mbi vlerësimet e performancës për nëpunësin civil si dhe menaxhon të gjithë procesin e vlerësimit aktual.

Forma e vlerësimit ruan informacione mbi:

- Objektivat e Institucionit, e Programit dhe Njesisë Organizative
- Objektivat dhe matësit e performancës për nëpunësin

-
- Vlerësimin e ndërmjetëm
 - Vlerësimin përfundimtar të punonjësit
 - Planin e zhvillimit profesional

Platforma administrative

- **Menu-ja e Punonjësve**

Mbart informacionin mbi kartelat e punonjësve:

- Të dhënat bazë
- Të dhëna për pozicionin e punës
- Masat Disiplinore
- Vlerësimet
- ASPA
- Historiku në institucion

Integrimi me sistemin e menaxhimit financiar për të përditësuar informacionin në kohë reale.

- **Menu e Administrimit**

Këtu caktohen dhe administrohen të drejtat e përdoruesve bazuar në pozicionet e tyre të punës. Përdoruesi në rolin administrator ka të drejtë të:

- Të përcaktojë emailët që do të dërgohen si njoftime (Tipi/lloji i emailit dhe personat të cilëve do u dërgohet)
- Të caktojë të drejta dhe role të përdoruesve duke ndjekur metodën RBAC (Role Based Access Control).
- Të konfigurujë menutë dhe funksionalitete të sistemit si dhe të përcaktojë të drejta që grupet e përdoruesve kanë mbi to.
- Të konfigurujë shabllone për importimin e të dhënave masive në sistem,

Në sistem konfigurohen ciklet e vlerësimit sipas procedurave aktuale dhe bazës ligjore mbi vlerësimet, përkatësisht:

- Cikli i Vlerësimit
- Fazat e ciklit të Vlerësimit
- Formatit i vlerësimit

Moduli i gjurmëve (log) dhe sigurisë

Ky modul shërben për monitorimin dhe auditimin e të gjithë veprimeve në sistem si dhe zbatimin e çështjeve të sigurisë lidhur me autentikimin dhe kredencialet.

Kërkesa të Përgjithshme

- Sistemi IMPRO i ka të gjitha modulet e integrueshme me njëra tjetrën dhe janë pjesë e një platforme të përbashkët. Kjo shmang përdorimin e aplikacioneve të ndryshme dhe përmbush qëlimin e një sistemi të vetëm.
- Funkcionet bazë të sistemit janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që të konfigurohen nga vetë përdoruesit lehtësisht nga ndërfaqja e aplikacionit.
- Në të gjitha ndërfaqet e tij, sistemi ka mundësi që të bashkëngjiten dokumenta të formateve të ndryshëm, word, pdf, excel etj dhe nuk ka limitime në nr e dokumentave që mund të bashkëngjiten.
- Sistemi lejon eksportin dhe importin e të dhënave në të gjitha ndërfaqet e moduleve të tij. Të dhënat eksportohen në formate të ndryshme.
- Sistemi IMPRO ofron një modul të plotë i cili përfshin menaxhimin e të gjithë përdoruesve të sistemit. Në këtë modul përcaktohen qartë pozicionet e punës për secilin përdorues, departamentet, të drejtat e aksesit, grupet ku përfshihet.
- Sistemi IMPRO mundëson krijimin e përdoruesve dhe të drejtave të tyre sipas rolit (pozicionit) që ato kanë. Sistemi lejon krijimin e një organigrame, e cila lidhet me përdoruesit e sistemit sipas roleve të tyre. Rolet respektojnë hierarkinë e insitucionit. Gjithashtu, një lloj roli mund të ketë të drejtë edhe të menaxhojë përdoruesit që i përkasin një roli tjetër 'inferior'.
- Sistemi të mundëson krijimin e të gjithë roleve të nevojshme, duke kombinuar entitetet si më poshtë:
 - Përdoruesin ose Grupin.
 - Qëllimin e Sigurisë (ç'ka do autorizohet).
 - Nivelin e Të Drejtave (Permission Level).
- Sistemi mundëson njoftime automatike të cilat përmbajnë të dhëna mbi marrësin, dërguesin, titullin, përmbajtjen e njoftimit, si edhe mundësi për t'i personalizuar këto shabllone.

6. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E MIRËMBAJTJES E SISTEMIT

Specifikimet Teknike të Mirëmbajtjes së sistemit

Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemit të Vlerësimit të Performancës janë të shprehura në komponentët e mëposhtme:

1. Monitorimi periodik i rregullt i roleve dhe aktivitetit të përdoruesve të sistemit. Kompania në bashkëpunim me BT duhet të nxjerrë raporte pas monitorimeve periodike të cilat duhet të përfshijnë:
 - d) Mos funksionim të shërbimeve të instaluar në rolet përkatëse.
 - e) Rritjen e madhësisë së logeve në masën që ndikojnë në performancën e sistemit.
 - f) Performancën dhe disponueshmërinë e ulët të sistemit.
2. Vlerësim i raporteve të monitorimit dhe përpilim i raporteve për përmirësimin e infrastrukturës, pa përjashtuar edhe sugjerimet në adresë të infrastrukturës.
3. Marrja, dokumentimi dhe dhënia e zgjidhjeve me prioritet të çështjeve të raportuara nga stafi duke ndihmuar stafin e BT në përdorimin e sistemit.
 - Dhënia suport në kryerjen e procedurave në kuadër të procesit të vlerësimit.
 - Marrja dhe dokumentimi i raportimit të bug-eve.

-
- Mbledhja dhe dokumentimi i kërkesave për ndryshim.
4. Kthimi i sistemit në gjendjen e mëparshme para se të ndodhte problemi. Kjo mund të përfshijë një rregullim të përhershëm ose një zgjidhje të përkohshme deri sa zgjidhja përfundimtare të gjendet.
 - Kryerja e rregullimeve të bug-eve të sistemit.
 - Rifitimi i funksionaliteteve pas mbylljes së sistemit në mënyrë jo normale.
 - Kryerja e analizës së plotë të shkakut nga vjen.
 5. Rregullimi i çështjeve/incidenteve në të gjithë shtresat e sistemit.
 6. Asistencë për raporte ose “queries” sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
 7. Planifikimi, menaxhimi i performancës së aplikimeve. Rregullimi i çdo çështje performance nëpërmjet update-mit dhe/ose ribërjes së aplikacionit.
 8. Kompania duhet të garantojë suport në rast se një faktor i brendshëm apo i jashtëm afekton sistemin.
 9. Ndërhyrjet në sistem duhet të propozohen me një akt plan të detajuar për t’u aprovuar. Kompania duhet të bëjë ndërhyrjet në kohën e përcaktuar.
 10. Modifikimi dhe përmirësimi i funksionaliteteve sipas kërkesave të Autoritetit. Pavarësisht se kjo kontratë synon procesin e mirëmbajtjes së Sistemit të Vlerësimit të Performancës, mund t’i lindë nevoja që herë pas here të kërkojë azhurnimin, përmirësimin apo modifikimin e sistemit duke u fokusuar por pa u kufizuar në:
 - Modifikimin e formularëve të përdorur në rast se do të jetë e nevojshme, sipas kërkesave ligjore.
 - Përmirësimi i performancës së proceseve aktuale
 - Përmirësimi i raporteve aktuale që gjenerohen nga sistemi sipas kërkesave të institucionit.
 11. Kompania duhet të kryejë kontroll periodik mujor, monitorues në vendndodhjen e klientit.
 12. Transferimi i njohurive stafit IT dhe stafit përdorues të sistemit.
 - Trajnimi mbi funksionalitetet e sistemit
 - Trajnimi mbi konfigurimin dhe monitorimin e sistemit
 - Trajnimi mbi strukturën e databazës dhe source code e sistemit.
 - Nëse do të nevojitet parametrizim i ri, kompania duhet t’i japë asistencë stafit IT .
 13. Ndërhyrjet në sistem duhet të propozohen me një akt plan të detajuar për t’u aprovuar. Kompania duhet të bëjë ndërhyrjet në kohën e përcaktuar.
 14. Kompania duhet të ofrojë suport lokal nga e hëna në të premte **08:00-17:00** deri në përfundimin e kontratës së mirëmbajtjes.
 15. Suporti i ofruar duhet të përfshijë kontrollin e detyrueshme parandaluese si dhe të përshkruajë dinamikën dhe furnizojë të gjitha detajet teknike mbi aktivitetet e planifikuara.

7. PËRGJIGJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT

a) Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë:

b) Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese.

Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjithë komponentët e këtij projekti. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rikuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit. Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese do të kryhen pranë Bashkisë Tiranë, përveç rasteve kur në kontratë përcaktohet një vendndodhje e re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

c) Shërbime Riparimi në vendndodhje

Operatori ekonomik duhet të jetë i disponueshëm gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar i Autoriteti Kontraktor (“Emergency On-Call Hours”). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të komponentëve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të sistemit dhe që nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i Autoritetit Kontraktor dhe të rekomanduara nga operatori ekonomik. Problemet që nuk i përkasin “Alarmeve Madhore”, duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

d) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.

Stafi përgjegjes do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë Autoritetin Kontraktor dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 15 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar. Në momentin e njohjes së thirrjes nga operatori ekonomik, personeli i autorizuar do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar.

e) Përgjigjia ndaj Alarmeve Madhore.

Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë nëpërmjet informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting, shkakun e Alarmit Madhor, atëherë ai duhet të dërgojë një teknik shërbimi brenda intervalit kohor prej 1 (një) ore nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do ti jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

f) Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit.

Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa:

- (a) Alarmi madhor të jetë korriguar ose të jetë “zgjidhur në mënyrë të tërthortë”;
- (b) Tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër;
- (c) Operatori ekonomik të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose;

(d) Operatori ekonomik arrin në konkluzionin që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

Operatori ekonomik duhet të dokumentojë cdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin e stafit përgjegjës për çdo ndërhyrje.

Operatori ekonomik do të realizojë një axhendë periodike kontrollesh si më poshtë:

1. Javore
 - Kontroll i log-eve të kryerjes se backup-eve
 - Kontroll i log-eve të aplikacionit
 - Mirëmbajtje proaktive.
2. Mujore.
 - Testim / kontroll i kompletuar i sistemit software
 - Kontroll i detajuar i gjithë log-eve software

Termet e Mirëmbajtjes:

- Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e mirëmbajtjes dhe shërbimeve të vazhdueshme (Marrëveshjen SLA) për tërë kohëzgjatjen e kontratës.

Kategoria A (Kritik/ I Larte)	Kategoria B (I Mesem)	Kategoria C (I Ulet)
Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimal aktivitetin
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</u>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesë te punës së tyre</u>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <u>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,</u>
Zgjidhje alternative e përkohshme		
<u>Nuk ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<u>Ka pjesërisht një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<u>Ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
○ 10 min. për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 1 ore.	○ 30 min.për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 2 orëve	○ 60 min.për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 4 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Bashkia e Tiranës

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar e kontratës që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur edhe nëse operatorët ekonomikë

arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;

b) ISO 20000-1 për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit;

c) ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit;

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën/çertifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

2.3.3 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë një personel teknik të diplomuar në një nga degët informatikë, elektronikë, telekomunikacion, informatikë-ekonomike apo të ngjashme me to, që do të angazhohet në zbatimin e kontratës, me këto kompetenca/ certifikata:

- a. 1 (një) punonjës të certifikuar si Auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001.
- b. 1 (një) punonjës të certifikuar për analizë software.
- c. 1 (një) punonjës të certifikuar për mbështetjen e kontratës sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente.

-
- d. 2 (dy) punonjës të certifikuar për platformën software që ka në përdorim autoriteti kontraktor ose ekuivalente.
 - e. 1 (një) punonjës të certifikuar për testim software.
 - f. 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim database.
 - g. 1 (një) punonjës të certifikuar për siguri në rrjet.

Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomat ose vërtetime nga universitetet përkatëse.
- Certifikata përkatëse
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Shënim: *a. Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, sjellim ne vemendje se:*

- *Autoriteti/enti kontraktor përpara fazës së nënshkrimit të kontratës do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 9 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.*

b. Operatori ekonomik fitues, para nënshkrimit kontratës duhet të dorëzojë:

